

KONTRATE SHITJE



Sot ne Tirane me date 11.04.2003, ndermjet paleve;

SHITES: Shoqeria "EDITA"S.r.l, person juridik Italian me nr.CCIAA 476964, rregjistrimi e cila perfaqesohet nga Dario Berti lindur me 10.11.59, me pasaporte nr.208196P i cili vepron ne baze te vendimit te Asamblese se kesa shoqerie date 7.01.2003.

BLERES: "EDIZIONI PANORAMA"S.r.l, person juridik Italian, me nr. CCIAA 419887. rregjistrimi, me seli ne Firenze V. le Spartaco Lavagnini 42 perfaqesuar nga Todoro Corrado lindur me 09.04.58 me banim ne, Pontasieve (FI) via dei Bosconi 10, me pasaporte nr.428800V, i cili vepron ne baze te vendimit te Asamblese se kesaj Shoqerie date 7.01.2003.

MEQENESE

Shitesi Shoqeria "EDITA"S.r.l, zoteron 35 pjese qe perbejne 35% te kapitalit te Shoqerise shqiptare "ÇELESI"Sh.p.k, e rregjistruar me vendimin e Gjykates se Tiranës nr. 18233, date 04.12.1997.

Me vendimin date 7.01.2003, Asambleja e Shoqerise Shoqeria "EDITA"S.r.l, ka miratuar shitjen e 35 pjese ose 35% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k.

Me vendimin date 7.01.2003, Asambleja e Shoqerise Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA"S.r.l, ka miratuar blerjen e 25 te pjeseve ose 25% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k. nga Shoqeria "EDITA"S.r.l.

Me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, date 11.04.2003, Asambleja ka dhene miratimin per shitjen e 25 pjeseve qe perbejne 25% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, nga pronari Shoqeria "EDITA"S.r.l, te bleresi Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA"S.r.l, perkundrejt çmimit prej 25.000Leke.

PALET BIEN DAKORT PERSA ME POSHTE VIJON

1. Shitesi Shoqeria "EDITA"S.r.l, i shet Bleresit Shoqerise "EDIZIONI PANORAMA"S.r.l, 25 pjese qe perbejne 25% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, perkundrejt çmimit 25000Leke.
- 1.1 Bleresi Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA"S.r.l, i pagoi Shitesit Shoqerise "EDITA"S.r.l, te gjithë vleren e çmimit te shitjes prej 25.000Leke, per vertetimin e shlyerjes se pageses, vlen kjo kontrate e nenshkruar nga te dyja palet.
2. Ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate Bleresi fiton pronesine mbi 25 pjeset qe perbejne 25% te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, dhe behet Ortak I kesaj Shoqerie duke zotuar 25 pjese te kapitalit te saj, ndersa Shitesi humb ne menyre te plote dhe definitive pronesine mbi to dhe mbi çdo te drejte tjeter qe I rridhte prej tyre.

3. SHitesi dhe Bleresi autorizojne qe kjo kontrate te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kjo kontrate kontrate hartohet ne 5 kopje me vlere te njejte, nga te cilat tre ne gjuhen shqipe dhe dy ne gjuhen Italiane dhe nenshkruhet nga Shitesi dhe Bleresi.

P A L E T

SHITES
Shoqeria "EDITA" S.r.l,

Berti Dario

Dario Berti
[Signature]

BLERES
"EDIZIONI PANORAMA" S.r.l,

Todoro Corrado

TODORO CORRADO
[Signature]